



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture), nga shoqëritë Volkswagen Finance Luksemburg SA dhe Rimac Automobili d.o.o.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.11 Prot., i AK, datë 05.01.2021 “Kërkesë për konsultim paraprak dhe mendim”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, që kombinon teknologjitë plotësuese të hiper-makinave të Bugattit (pjesë e Grupit Volkswagen) dhe biznesit të hiper makinave Rimac.

Sipas “Marrëveshje e Opsionit të Vendorsjes”, nënshkruar më datë 22 mars 2021 palët janë:

**Pala 1: Rimac Automobili d.o.o** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas ligjeve të Kroacisë, e cila operon në tregun e automjeteve, aktive në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e pjesëve për automjete elektrike dhe zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e makinave ekskluzive dhe të kufizuara (elektrike) sportive me performancë të lartë (hiper-makina) etj.

**Pala 2: Volkswagen Aktiengesellschaft** është një shoqëri aksionare gjermane, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me seli në Gjermani. Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

*Porsche Leasing SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

*Porsche Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

**Përfituesi 1: Volkswagen Finance Luksemburg SA** është një shoqëri aksionare, e organizuar sipas ligjeve të Luksemburgut dhe është pjesë e menaxhimit dhe industrisë së ndërmarrjeve. Volkswagen Finance Luksemburg SA është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.

**Përfituesi 2: Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft**, është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, e cila operon në prodhimin, zhvillimin dhe shitjen kryesisht të makinave sportive dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbime financiare për automjetet, duke përfshirë marketimin e shërbimeve të konektivitetit, nëpërmjet markës ndihmëse MOIA.

Porsche është pjesë e Grupit Volkswagen, me anë të biznesit Bugatti, i cili përbëhet nga 3 entitete: Bugatti Automobiles SAS, Francë, (entitet aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e hiper-makinave), Bugatti International SA, Luksemburg (entitet që mban dhe administron markat tregtare Bugatti) dhe Bugatti Engineering GmbH, Gjermani (nuk do të jetë pjesë e transaksionit të propozuar).

**New-Co / JV** do të jetë ndërmarrja e përbashkët, e cila do të krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Kroaci. NewCo do të jetë një shoqëri e qëndrueshme dhe me vetë-financim, aktive në prodhimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e hiper makinave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**